

Bëhuni Gati për Ditën e Parë të Shkollës ditën E enjte, 4 Shtator!



Ja disa hapa të thjeshtë për të ndihmuar familjen tuaj të nisë mbarë vitin e ri shkollor:

☐ **Përditësoni informacionin tuaj të kontaktit.**

Sigurohuni që shkolla e fëmijës tuaj të mund t'ju kontaktojë! Hyni në Llogarinë tuaj të Shkollës të NYC (Schools Account-NYCSA), te portali ynë për prindër, për të përditësuar numrin e telefonit, adresën postare dhe e-mailin. Mund të plotësoni gjithashtu, formularin e kontaktit të emergjencave që ua mundëson shkolla. Nuk e keni ende një NYCSA? Vizitoni schools.nyc.gov/NYCSA për t'u regjistruar.

☐ **Lini takim për një kontroll mjekësor për fëmijën tuaj.**

A po ndjek fëmija juaj shkollën ose kujdesin ditor për herë të parë? Ai/ajo do të ketë nevojë për një kontroll mjekësor nga një ofrues i kujdesit shëndetësor, i cili gjithashtu, do të duhet të plotësojë një Formular Kontrolli të Shëndetit për Fëmijët dhe Adoleshentët (Child and Adolescent Health Examination Form - CH-205). Shkarkoni një CH-205 në schools.nyc.gov/SchoolHealth.

☐ **Sigurohuni që fëmija juaj të ketë marrë të gjitha vaksinat e nevojshme.**

Ligji i Shëndetit Publik i Shtetit të Nju Jorkut kërkon që nxënësit dhe nxënëset të kenë marrë vaksina të caktuara për të ndjekur kujdesin ditor ose shkollën. Ju mund të gjeni më shumë informacion mbi vaksinimet e nevojshme të nxënësit/es në faqen schools.nyc.gov/Immunization. Vizitoni vaccinefinder.nyc.gov ose telefononi **877-829-4692** për të gjetur vendin më pranë jush ku mund të bëni vaksinat e kërkuara dhe të rekomanduara.

☐ **Kontrolloni kalendarin e shkollave publike të NYC për vitin shkollor 2025–26.**

Mbani shënime datat e rëndësishme, si ditët e pushimeve, takime prindër-mësues dhe më shumë! Vizitoni schools.nyc.gov/Calendar për të parë dhe printuar kalendarin për këtë vit shkollor në gjuhë të ndryshme.

☐ **Mësoni për opsionet dhe të drejtën e përfitimit për transport të fëmijës tuaj.**

A e dini si do të udhëtojë fëmija në shkollë dhe nga shkolla? Vizitoni schools.nyc.gov/Transportation për më shumë informacion mbi shërbime të mundshme transporti.

- Mësoni mbi kartat falas për Nxënësit/et OMNY në schools.nyc.gov/OMNY.
- Nëse fëmija juaj përfiton shërbim me autobus të shkollës, mund të kontrolloni itinerarin, oraret e marrjes dhe kthimit të tij/saj përmes aplikacionit zyrtar të Autobusëve të Shkollës së NYC! Hyni duke përdorur Llogarinë tuaj të Shkollës të NYC. Mësoni më shumë në schools.nyc.gov/SchoolBusApp.

☐ **Flisni me fëmijën tuaj mbi mos përdorimin e pajisjeve elektronike në shkollë.**

Sipas ligjit të Shtetit të Nju Jorkut, nxënësit/et e NYCPS-ve nuk mund të përdorin pajisje elektronike personale me qasje në internet, të tilla si telefona celularë, në mjediset e shkollës gjatë orarit mësimor. Shkolla juaj do të ndajë me ju politikën përkatëse mbi përdorimin dhe ruajtjen e pajisjeve — lexojeni këtë material me fëmijën tuaj, me qëllim që ata të kuptojnë rregullat para se të nisë viti shkollor. Për më shumë informacion, vizitoni schools.nyc.gov/DevicePolicy.

☐ **Përgatitni pajisjet shkollore të fëmijës suaj.**

Shkolla ose mësuesi/mësuesja e fëmijës suaj mund t'ju dërgojë një listë me pajisjet që do të nevojiten këtë vit. Bisedoni me fëmijën tuaj mbi çfarë mund të presë në ditën e parë të shkollës dhe sigurohuni që të ketë pajisjet e paketuara dhe gati për t'u përdorur. Vendosni emra në gjithçka të tyre (rroba, shishe uji, kuti me lapsa, etj.) që të mund t'ju kthehen nëse humbasin.

Shihni anën e pasme të faqes për më shumë informacion. ►

❑ **Ndihmoni fëmijën tuaj të përgatitet për orarin e vitit shkollor.**

Para ditës së parë të shkollës, përcaktoni një orar konsistent gjumi, për t'i ndihmuar të përshtaten me një rutinë të shëndetshme dhe të rregullt. Disa ditë para fillimit të shkollës, praktikoni rutinën e mëngjesit që do të ndiqet gjatë këtij viti shkollor, përfshirë përgatitjen dhe udhëtimin drejt shkollës së fëmijës suaj. Sigurohuni që të njihni orarin e fillimit, të mbarimit dhe politikën për vonesat në shkollën tuaj.

❑ **I kërkonti shkollës për shërbime të përkthimit dhe interpretimit.**

NYCPS-të përkthejnë dokumentet zyrtare në 12 gjuhë — Arabe, Bangla, Kineze (Tradicionale dhe e Thjeshtuar), Franceze, Kreole Haitiane, Koreane, Ruse, Spanjolle, Urdu dhe — për këtë vit shkollor — Shqip, Ukrainase dhe Uzbeke.

- Nëse keni nevojë për mbështetje shtesë, shkolla juaj mund t'ju ofrojë shërbime përkthimi dhe interpretimi falas. Pyesni drejtorin/en e shkollës suaj ose koordinаторin/en e prindërve, ose vizitoni [schools.nyc.gov/Hello](https://schools.nyc.gov>Hello) për më shumë informacion. Për shërbime interpretimi të Gjuhës Amerikane të Shenjave (ASL), vizitoni schools.nyc.gov/SignLanguage.

❑ **Kontaktoni koordinаторin/en e prindërve të shkollës suaj.**

Koordinatorët/et për prindër mund t'ju ndihmojnë të merrni përgjigje për shumë nga pyetjet tuaja! Gjeni informacionet e kontaktit me mjetin "Gjeni një Shkollë" ("Find a School") në schoolsearch.schools.nyc ose duke telefonuar shkollën e fëmijës suaj.

❑ **Përgatituni për mësim në distancë, nëse do të jetë nevoja.**

Në rast të mbylljes së shkollës për shkak të motit ose emergjencave, nxënësit/et do të ndjekin mësimin në distancë nga shtëpia. Sigurohuni që fëmija juaj të ketë një pajisje të lidhur me internet, materialet shkollore dhe një vend të qetë për të punuar. Ndihmohuni të hyjnë në Llogarinë e Nxënësit në NYCPS për të përdorur mjetet online, që i duhen për detyrat e shkollës. Gjeni burime për t'u përgatitur për mësimdhënie në distancë në schools.nyc.gov/DigitalLearning.

Presim me padurim të fillojmë vitin shkollor me ju më datë
4 Shtator!